




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, [www.gjilani-komuna.org](http://www.gjilani-komuna.org); e-mail: zip\_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në nenin 38.1 shkronja g) të Statutit të Komunës së Gjilanit, si dhe duke u bazuar në Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 25.01.2011, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 01.02.2011, miratoi këtë:

## V E N D I M

### **Për lejimin e ridestinitimit të mjeteve të donatorëve dedikuar sanimit të dëmeve nga breshëri, për mbulimin e shpenzimeve të Komisionit për evidentimin e dëmeve të breshrit**

#### I

Me këtë vendim lejohet ridestinimi i mjeteve të donatorëve dedikuar sanimit të dëmeve nga breshëri, për mbulimin e shpenzimeve të Komisionit për evidentimin e dëmeve të breshrit.

#### II

Lartësia e mjeteve për të cilat lejohet ridestinimi është 1800.00€, dhe këto mjete janë dhënë nga donatorët në emër të sanimit të dëmeve nga breshëri dhe sipas këtij vendimi këto mjete do të përdoren për mbulimin e shpenzimeve të krijuara në teren nga komisioni për evidentimin e dëmeve të shkaktuara nga breshëri.

#### III

Autorizohet Kryetari i Komisionit për grumbullimin e mjeteve nga Donatorët që t'i ndërmarr të gjitha procedurat e nevojshme për ekzekutimin e këtij vendimi.

#### IV

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit

#### V

Vendimi është i plotfuqishëm ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

01. Nr. 16-1329  
Gjilan, më 01.02.2011

Kuvendi i Komunës.  
\_\_\_\_\_  
Izmi Zeka, Kryesues